



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:188092
Datë: 26.06.2024
Numri i dokumentit: 05863951

2023:188093

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit R.R. nga f. ...-K.Ferizaj, me nr. personal ..., të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Blerina Islami nga Ferizaj kundër të paditurës Komuna Ferizaj, Drejtoria për Arsim, të cilën me autorizim e përfaqëson i autorizuari S.V., për kompensimin e tri pagave përcjellëse pas pensionimit, vlera e kontestit 1810€, me datë 26.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit R.R. nga f. ...-K.Ferizaj, me nr. personal ... me të cilën ka kërkuar që të “DETYROHET e paditura Komuna Ferizaj, Drejtoria për Arsim, që paditësit të ia paguajë në emër të kompensimit të tri pagave përcjellëse pas pensionimit në lartësi prej 1810,00 € (njëmijë e tetëqind e dhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga data 05.09.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij av. Blerina Islami nga Ferizaj në këtë gjykatë me datë 05.09.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës, për kompensimin e tri pagave përcjellëse pas pensionimit duke theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën Komuna Ferizaj, Drejtoria për Arsim, i njëjti fillimisht i ishte drejtuar me kërkesë të paditurës dhe nga e njëjta ka pranuar përgjigjen “se nuk kemi mjete drejtohu gjykatës”, andaj paditësi pasi ka kuptuar

se pagesa nuk do t'i kryhet është detyruar të ushtroj padi, përmes së cilës ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale. Gjatë seancës përgaditore dhe kryesore të dt. 18.06.2024 dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e paditësit ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke shtuar se paditësi ka arritur moshën e pensionimit me datë 23.06.2023 dhe ka parashtruar padi për kompensimin e pagave përcjellëse në shumën e përgjithshme prej 1810 euro e cila nuk i është paguar, gjë e cila është bërë për punonjësit e tjerë dhe që të mos ketë diskriminim në mes punonjësve konsideron se duhet të aprovet dhe të vendoset siç është cekur në petitumin e kërkesëpadisë së paditësit, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, me arsyetimin se paditësi është pensionuar dhe kërkesën e ka mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit e cila është shfuqizuar me dt. 21.11.2022, po ashtu thirret në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe propozon që të refuzohet padia, ndërsa shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të saktë të gjendjes faktike lidhur me çështjen lëndore të palëve ndërgjyqëse, në këtë shqyrtim administroi si prova: Vendimin për përvojë pune dhe pensionim nr. 173/23, i dt. 21.06.2023 i të paditurës, listat e pagave për muajt mars, prill, maj 2023.

Pas administrimit dhe çmuarjes me ndërgjegje dhe kujdes të provave, konform nenit 8 të LPK-së, konstatoi këtë gjendje faktike:

- Nga vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës i datës 21.06.2023, me numër 173/23, është vërtetuar fakti se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit prej datës 23.06.2023 dhe
- Nga listat e pagave për muajt mars, prill, maj 2023 janë vërtetuar shumat me të cilat është paguar paditësi para pensionimit.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe në shqyrtimin e datës 18.06.2024, gjykata ka gjetur se e drejta për kompensimin e tri pagave përcjellëse është paraparë me Kontratën Kolektive të Arsimit të dt. 21.01.2021. Në nenin 35.9 të kësaj kontrate është paraparë se 'Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit'. Por sipas pikës IV. të mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 214/2023, i datës 09.10.2023, parashihet

se: “Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur me dt. 22.01.2021 e nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), aplikohet në periudhën kohore nga dt. 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022.

Gjykata nga vendimi për përvojë pune dhe pensionim nr. 173/23, i dt. 21.06.2023 i të paditurës, ka vërtetuar faktin se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit prej datës 23.06.2023. Meqenëse në kohën kur është pensionuar paditësi nuk ka pasur kontratë kolektive të vlefshme në fuqi, kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në pikën e dytë të dispozitivit të aktgjykimit, ashtu që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 450 të LPK-së.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gj y q t a r i,

Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.